



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 347, datë 22.11.2023

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” PËR DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC “KOMAN”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 317, datë 08.11.2023, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1937/9 prot., datë 20.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” për dhënien e Garancisë së Origjinës”

Konstatoi se:

- Shoqëria KESH sha, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1937/4 prot, datë 26.10.2023, ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Garancinë e Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Koman” për periudhën (01.10.2022-30.09.2023).
- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 317, datë 08.11.2023, janë vendosur disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, të cilat do të jenë në fuqi për një periudhë tranzitore, deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së re për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023.

- Duke qenë se aplikimi i shoqërisë KESH sha po shqyrtohet gjatë kësaj faze tranzitore, ku janë në fuqi ndryshimet e vendosura me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 317/2023, në analizimin e këtij dokumentacioni janë mbajtur në konsideratë përcaktimet e këtij vendimi.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, me shkresën nr. 1937/5, datë 08.11.2023, ERE i është drejtuar KESH sha, me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit/informacionit të konstatuar të munguar të këtij aplikimi.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1937/7 prot., datë 14.11.2023, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- ERE i është drejtuar OST sha me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky hidrocentral gjatë kësaj periudhe, si dhe kodin/numrin e matësve për secilin hidrocentral.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1937/8 prot., datë 17.11.2023, OST sha ka paraqitur informacion në formë tabelare për kodin/numrin e matësve për secilin hidrocentral, si dhe informacion të ndarë sipas muajve (tetor 2022-shtator 2023) dhe totalin, nga ku rezulton se sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në rrjet për këtë periudhë nga HEC “Koman” është 2,264,089 MWh.
- Sa më sipër, në dhënien e GO do të merret parasysh sasia e energjisë sipas shkresës së OST sha për këtë hidrocentral.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 317, datë 08.11.2023, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënien e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
- Për sa më sipër, vlerësohet dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë e prodhuar për periudhën 01.10.2022 deri më 30.09.2023 nga Hec “Koman”, për sasinë 2,264,089 MWh.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pika 5 të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar për periudhën 01.10.2022 deri më 30.09.2023 nga Hec “Koman”, për sasinë 2.264,089 MWh.
2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI